



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.172 dt.31.10.1997

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Tiranës, i mbledhur me dt.31.10.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Ndërtim Strehimit “Për kalim në fond banese të bodrumeve në Rr.”Zhan D’ark” Pallatet e Lanës Shk.1 – 8” të pa privatizuara deri sot bazuar në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.97, dt.30.07.1996 pika V si dhe Dekretit të Presidentit Nr.1440, dt.04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të pa privatizuara” :

**VENDOSI**

1. Të kthejë në fond banese 90 bodrumet e pa privatizuara që ndodhen në Rr.”Zhan D’ark” Pallatet e Lanës Shk. 1 – 8 sipas tabelës bashkangjitur e relatuar nga Drejtoria e Ndërtim Strehimit.
2. Ngarkohet Drejtoria e Ndërtim Strehimit të përgatisë materialin për Këshillin Bashkiak për privatizim bodrumi rast për rast mbi bazën e strukturave përkatëse të këtyre banesave mbështetur në Ligjin Nr.7652, dt.23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”.
3. Për rastet kur për të njëjtin bodrum kanë kontratë qytetarët sipër dhe qytetarët poshtë, do ti drejtohen Gjykatës për zgjidhje.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**

